REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 2710 prot. Lushnje më, 17/03/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

"PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB-121 DATË 23.12.2025 „PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË LUSHNJE, INSTITUCIONEVE NË VARËSI DHE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026 „

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Në bazë të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma "ç" i cili citon: "ç) miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi", Ligji 35/2023 „Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi;ligjit nr. 10405 "Per Kompetencat per Caktimin e pagave dhe Shperblimeve", ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 27.2.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar" dhe VKM-në nr 131 datë 27.02.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar*, ju paraqesim propozimin për miratimin e vendimeve të reja të marra nga Këshilli i Ministrave mbi ndryshimet e pagave,sipas projekt-vendimit bashkalidhur.

Ju faleminderit!

Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

Kryetar i Bashkisë
Eriselda Sefa

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKAE SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.2710/1 Prot.

Lushnje më, 17 /03 /2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 36 , DATË 17/03 / 2026

"PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB 121 DATË 23.12.2025 „PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË LUSHNJE, INSTITUCIONEVE NË VARËSI DHE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2026 „

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës / / 2026 në zbatim të Urdhërit nr 361/1 datë 17/02/2025„Për miratimin e strukturës/organikës dhe kategoritë e pagave të Bashkisë Lushnje dhe ndërmarrjeve vartëse për vitin 2026"; Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " ,neni 54 "Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak" gërma "ç" i cili citon: *"miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi"* ,neni 8 dhe neni 64 ;Ligji 35/2023 „Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi"nenet 9 ; Ligji Nr. 152/2013 „Për Nëpunësin Civil",i ndryshuar;Ligji nr 7961 datë 12.07.1995 Kodi i Punës së RSH",i ndryshuar; *; VKM nr 104 datë 11.02.2026 „Për një ndryshim të VKM-së 419 datë 26.06.2024"Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit"; VKM-së nr 103 datë 11.02.2026 „Për disa ndryshime në VKM-në nr 328 datë 31.05.2023 „Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore,për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore",të ndryshuar ;VKM-së nr 425 datë 26.06.2024 „Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjesve të tjerë jomësimor dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar",përkatesisht lidhjet nr 3 dhe 4; VKM -së nr 87 datë 06.02.2026 „Për disa ndryshime në VKM-në nr 326 date 31.5.2023"Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të adminiostratës publike",të ndryshuar,VKM-së nr 127 datë 27.02.2026 , Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 127, datë 27.2.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të*

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

sistemit arsimor parauniversitar" dhe VKM-në nr 131 datë 27.02.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar

PROPOZOJMË :

1. Te Lidhja Nr.5 pika 17 bëhen këto ndryshime:

   Sektori Ujitjes dhe Kullimit
   -Përgjegjës nga 105,000 bëhet 109,000
   -Specialist nga 70,000 bëhet 75,000

2. Te Lidhja Nr.5 pika 18 bëhen këto ndryshime:

   - Drejtor kopshti me ushqim nga 80,000 bëhet 82,000
   - Drejtor kopshti pa ushqim nga 75,000 bëhet 77, 000
   - Edukator Kopshti nga 58,000 bëhet 61,000
   - Kujdestar Konvikti nga 58,000 bëhet 61,000
   -Punonjës për magazinën nga 58,000 bëhet 61,000
   -Drejtori QKF nga 99,500 bëhet 102,000
   -Përgjegjës Sektori QKF nga 73,000 bëhet 76,000
   -Instruktor në QKF nga 60,000 bëhet 63,000

3. Te lidhja nr 5 shtohet pika 29 si më poshte:
   -Përgjegjes i Zyrës së Gjendes Civile në bashki nga 98,000 bëhet 102,000
   -Përgjegjes i Zyrës së Gjendes Civile në Njësi Adiminstrative nga 90,000 bëhet 95,000
   -Specialist i Zyrës së Gjendjes Civile nga 70,000 bëhet 75,000.

4. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1 Janar 2026.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe ndrmarrjet në varësi në varësi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Burimeve Njerezore
Erisa Qalliu

Drejtoria e Finances dhe Buxhetit
Ervisa Çuko

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Kryetar i Bashkisë
Eriselda Sefa

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com